



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Gjykimin e çështjes penale me nr. 177/1 procedimi të vitit 2025, ndaj të pandehurve **Musa Gjikota, Erjon Dani dhe Vilson Roçi**”.

2. Gjykimi i kësaj çështje u zhvillua me rregullat e gjyimit të shkurtuar. Në përfundim të gjyimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Rudina Palloj, Atalanta Zeqiraj dhe Flojera Davidhi, me vendimin nr. **9**, datë **05.02.2026** vendosi:

- 1.** Deklarimin fajtor të të pandehurit **Musa Gjikota** për kryerjen e veprës penale “*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*”, në bashkëpunim (për episodin 1), parashikuar nga neni 245/1, pg. 1 dhe 25 i Kodit Penal (sipas formulimit të dispozitës para ndryshimeve me ligjin nr. 43/2021) dhe dënimin e tij me **1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim**.
- 2.** Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurit **Musa Gjikota** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me **1 (një) vit burgim**.
- 3.** Llogaritja e dënimit për të pandehurin **Musa Gjikota** fillon nga momenti i arrestimit të tij më datë 11.07.2025, dhe dënimi me burgim do të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme.
- 4.** Deklarimin fajtor të të pandehurit **Erjon Dani** për kryerjen e veprës penale “*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*”, (për episodin 1), parashikuar nga neni 245/1, pg. 2 i Kodit Penal (sipas formulimit të dispozitës para ndryshimeve me ligjin nr. 43/2021) dhe dënimin e tij me **2 (dy) vite burgim**.
- 5.** Deklarimin fajtor të të pandehurit **Erjon Dani** për kryerjen e veprës penale “*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*”, (për episodin 2), parashikuar nga neni 245/1, pg. 2 i Kodit Penal (sipas formulimit të dispozitës para ndryshimeve me ligjin nr. 43/2021) dhe dënimin e tij me **2 (dy) vite burgim**.
- 6.** Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Erjon Dani**, akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pasi në referim

të nenit 388, pika 1, shkronja b) të Kodit të Procedurës Penale, *pasi fakti objekt akuze nuk përbën vepër penale*.

7. Në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve, i pandehuri **Erjon Dani** dënohet me një dënim të vetëm prej **3 (tre) vite** burgim.
8. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurit **Erjon Dani** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me **2 (dy) vite** burgim.
9. Llogaritja e dënimit për të pandehurin **Erjon Dani** fillon nga momenti i arrestimit të tij më datë 11.07.2025 dhe dënimi me burgim do të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme.
10. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Vilson Roçi** për kryerjen e veprës penale “*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*”, në bashkëpunim (për episodin 2), parashikuar nga neni 245/1, pg. 1 dhe 25 i Kodit Penal (sipas formulimit të dispozitës para ndryshimeve me ligjin nr. 43/2021) dhe dënimin e tij me **1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj** burgim.
11. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Vilson Roçi** për kryerjen e veprës penale “*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*”, në bashkëpunim (për episodin 3), parashikuar nga neni 245/1, pg. 1 dhe 25 i Kodit Penal (sipas formulimit të dispozitës para ndryshimeve me ligjin nr. 43/2021) dhe dënimin e tij me **1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj** burgim.
12. Në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve, i pandehuri **Vilson Roçi** dënohet me një dënim të vetëm prej **1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj** burgim.
13. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurit **Vilson Roçi** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me **1 (një) vit** burgim.
14. Llogaritja e dënimit për të pandehurin **Vilson Roçi** fillon nga momenti i arrestimit të tij më datë 11.07.2025, dhe dënimi me burgim do të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme.
15. Shpenzimet procedurale të bëra gjatë hetimeve paraprake, sipas procesverbalit për evidentimin e shpenzimeve të hetimit, dhe ato gjyqësore, sipas procesverbalit përkatës për evidentimin e shpenzimeve gjyqësore, në referim të neneve 393/1 dhe 285/1 të K.Pr.Penale, i ngarkohen të pandehurve të cilët deklarohen fajtorë me këtë vendim, në mënyrë solidare.
16. Ngarkohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për zbatimin e këtij vendimi.
17. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmbja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Tiranë, më datë 05.02.2026

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar